



Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më ____ . ____ . 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “KLEDIA-06” sh.p.k, NIPT K47905866L & “H&E Energy” sh.p.k, NIPT L71716029A, me adresë: Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga “Muhamet Gjollësia”, Pallati Nr.16, Shkalla 1, Apartamenti 12, Zona Kadastrale 8260, Nr Pasurie 5/245+1-12, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar - mallra.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: NR. REF-07866-06-04-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Zëvendësim i 10 Elektro-pompave të IVP-së të agregateve në HEC Vau Dejës, dhe furnizimi i një pajisje profesionale me 16 kanale për matjen e vibrimeve dhe “air gap” për makinat rrotulluese”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (Dymbëdhjetë) muaj.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.30, datë 10/06/2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1) Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “KLEDIA-06”, NIPT K47905866L & “H&E Energy” sh.p.k, NIPT L71716029A, me ofertë ekonomike 93,000,000 (Nëntëdhjetë e tre milion) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Nuk ka.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin i Operatorëve Ekonomik “KLEDIA-06” sh.p.k, NIPT K47905866L & “H&E Energy” sh.p.k, NIPT L71716029A, me adresë: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Muhamet Gjollësia”, Pallati Nr.16, Shkalla 1, Apartamenti 12, Zona Kadastrale 8260, Nr Pasurie 5/245+1-12, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 93,000,000 (Nëntëdhjetë e tre milion) Lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Përsa i përket afateve të ankimit, referuar nenit 96 pika 2 gërma (a) të Ligjit Nr.162 datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku citohet se “Periudha e pritjes, e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, nuk zbatohet në rastin e procedurave me një ofertues të vetëm, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues”, për procedurën e sipërcituar, duke qenë se ka pasur vetëm një ofertues të kualifikuar dhe të shpallur fitues, nuk aplikohet periudha e pritjes.

Rrjedhimisht jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor KESH sh.a, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erlind Sulo